UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Raporti i vlerësimit të cilësisë për vitin akademik 2025/2026
Fakulteti Menaxhmenti
Programi: Menaxhim i Biznesit dhe Ndërmarrësia-BSc

- **Hyrja**

Programi **Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia** (MBN) në kuadër te **Fakultetit Menaxhmenti** gjatë vitit akademik 2025/26 ka ofruar mësim për studentët sipas plan-programit të Akredituar 2022/25 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Programi MBN u ofron studentëve njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e biznesit dhe të menduarit ndërmarrës. Kurrikula e programit MBN është e hartuar në bashkëpunim me industrinë dhe duke i marre përvojat me te mira ndërkombëtare – ajo është përshtatur me trendët zhvillimore në tregun e punës dhe për studentët ofron njohuri, aftësi/shkathtësi dhe kompetenca nga fushat inovacion, financa, ligjet, vendimmarrje biznesore, pastaj fushat ekonomike, menaxhim të projekteve dhe operacioneve, kontabilitet, marketing dixhital, menaxhim ndryshimi, etj, te cilat janë kërkesa edhe nga tregu i punës.

Fakulteti Menaxhmenti ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë aftësitë/shkathtësitë e duhura konformë kërkesave të ekonomisë moderne për profesionin të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është “të përgatisë kuadro (profesionist) të kualifikuar të cilët përmes metodave të avancuara në menaxhimin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrësisë do të kontribuojnë në ndryshime pozitive të vazhdueshme të ambientit biznesor”.

Misioni i programit është në harmoni të plotë me **Misionin e *Universitetit*** “*...të përgatisim profesionistë të kualifikuar, hulumtues të përkushtuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive”*.)


Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2025/26 përmban te dhëna për vlerësimin e programit, për vlerësimin e stafit akademik/lëndës dhe për vlerësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve.

1. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë (program, stafi akademik/lënda, infrastrukturë)

Raporti i përgjithshëm - për tri fusha (program, stafi akademik/lënda dhe infrastrukturë / shërbime), paraqet në Tabelën nr. 1 – te dhënat për vitin akademik 2025/26, te ilustruara edhe ne Grafikun1. Pyetjet për tri fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave (programi, stafi akademik dhe infrastrukturë)

	Vitet Paraprake		Viti aktual
	2023/24	**2024/25**	**2025/26**
Vlerësimi i stafit akademik/lënda	**4.26**	**4.21**	**4.32**
	2023/24		**2025/26**
Vlerësimi i programit	**3.88**		**4.61**
Vlerësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve			**3.24**



Grafika 1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave (programi, stafi akademik dhe infrastruktura),

Nga te dhënat e paraqitur në tabelën nr.1 dhe të pasqyruara në grafikën nr.1 – për fushat e vlerësuara nga studentet – vërehet se vlerësimi i programit, i stafit dhe i infrastrukture është me notë shumë të mirë, kjo e obligon menaxhmentin e Fakultetit dhe stafin që të jenë të përkushtuar për të vazhduar ecurinë pozitive të aktiviteteve në kuadër të programit me synim përmirësimin e vlerësimit në periudhën e ardhshme.

2. Raporti i vlerësimit të stafit akademik/lëndës

Raporti i vlerësimit për stafin akademik/lëndën në kuadër të programit MBN, paraqet të dhëna për vitin akademik 2025/26. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i stafit akademik/lëndës nga studentët është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 11 komponentë për të cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit janë paraqitura në tabelën nr.2, nga te dhënat e prezantuara vërejmë se i gjithë stafi akademik/lënda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare në nivel të programit për mësimdhënës/lëndë është 4.32 një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e mësimdhënësve në lëndët përkatëse.

Tabela nr.2 - Vlerësimi i stafit akademik/lëndës

		Vitet paraprake		Viti aktual
Nr.	**Emri i Lëndëve**	**2023/24**	**2024/25**	**2025/26**
1	Informatika ne biznes	**4.33**	**4.60**	**4,63**
2	Matematika për biznes	**4.27**	**4.37**	**3,87**
3	Mjedisi Biznesor	**4.45**	**4.51**	**4,47**
4	Hyrje ne ekonomi	**4.51**	**4.52**	**4,57**
5	Shkathtësi akademike dhe komunikim në Biznes	**4.24**	**4.51**	**4,33**
6	Menaxhmenti	**4.31**	**4.57**	**4,58**
7	Vendimmarrja ne Biznes	**4.21**	**4.28**	**4,68**
8	Menaxhimi i Inovacioneve	**4.36**	**4.48**	**4,62**
9	Statistika Biznesore	**3.99**	**4.45**	**4,51**
10	Gjuhe Angleze I	**4.19**	**4.57**	**4,52**
11	Gjuhe Gjermane I	**4.18**	**4.34**	**4,48**
12	Analiza e Tregut dhe Sjellja Konsumatore	**4.11**	**4.31**	**4.71**
13	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	**3.88**	**4.00**	**4.26**
14	Marketingu	**3.99**	**4.00**	**4.55**
15	Menaxhimi i operacioneve	**3.85**	**4.19**	**4.56**
16	Gjuhe Angleze II	**3.50**	**3.74**	**4.31**
17	Gjuhe Gjermane II	**4.23**	**3.97**	**4.36**
18	Menaxhimi i dijes	**4.08**	**4.15**	**4.71**
19	Ndërmarrësi Sociale	**4.31**	///	**4.90**
20	Ndërmarrësia	**3.79**	**4.19**	**4.71**
21	Kontabiliteti	**4.05**	**4.02**	**4.26**
22	E Drejta Biznesore dhe Etika	**3.97**	**3.94**	**4.58**
23	Sjellja Organizative	**3.92**	**4.19**	**4.44**
24	Gjuhe Angleze III	**3.40**	**4.13**	**4.38**
25	Gjuhe Gjermane III	**4.01**	**3.97**	**4.41**
26	Menaxhimi i Sistemit Informativ ne Ndërmarrje	**4.06**	**4.25**	**4.40**
27	Qëndrueshmëria e Ambientit dhe Ndërmarrësia	**4.31**	**4.56**	**4.60**

28	Menaxhimi i marrëdhënieve me klientë	///	**4.09**	**4.56**
29	Shitja dhe Menaxhimi i shitjes	///	**3.89**	**4.63**
30	Menaxhimi i Ndryshimeve	///	**3.90**	**4.64**
31	Produkti dhe Vendosja e Çmimeve	**4.36**	**4.31**	**4.67**
32	Menaxhimi strategjik	**4.28**	**3.90**	**4.70**
33	Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në ndërmarrje	///	**4.24**	///
34	Planifikimi Biznesor	///	**4.16**	**4.72**
35	Menaxhimi i projekteve	**4.04**	**4.07**	**4.78**
36	Menaxhimi i Financave	**4.50**	**4.36**	**4.26**
37	Intership (Mësim praktik në ndërmarrje)	///	**3.84**	**4.84**
38	Lidershipi	///	**4.33**	**4.77**
39	NVM	**4.34**	**4.24**	**4.77**
40	Loxhistika dhe Transporti	///	**3.89**	**4.79**
41	Mediat sociale dhe ekonomia dixhitale	///	**4.28**	**4.74**
	Mesatarja e përgjithshme:	**4.26**	**4.21**	**4.32**

Duke u bazuar në të dhënat e përpunuara dhe të prezantuara në tabelën nr.2 (vlerësimi i stafit akademik / lëndës), vijmë në përfundimin se shumica absolute e mësimdhënësve dhe lëndëve kanë marrë një vlerësim të lartë - mbi notën 4 – vetëm një mësimdhënës/lëndë ka marrë një vlerësim ma të ulët - nënë notën 4, në bazë të këtyre të gjeturave rekomandohet që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të vijuar ecurinë e punës profesionale të stafit duke synuar rritjen e performancës dhe përmirësim të vazhdueshëm të vlerësimit për periudhën vijuese, derisa stafi/lënda me vlerësim nënë notën 4 duhet te tregoj angazhim për përmirësim në periudhën vijuese të vlerësimit (për këtë rast do te bisedohet dhe do të kërkohet angazhim shtesë në procesin mësimorë).

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia (MBN) 2025/26 është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 21 komponentë, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate e vlerësimit të programi - mësimdhënia dhe mësim-nxënia të paraqitura në Tabelën nr.3, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare e vlerësimit te programit është 4.61 që është një vlerësim shumë i mirë – i cili kërkon përkushtim per vijueshmëri me synim për tu përmirësuar në vitin pasues.

Tabela nr.3 – Vlerësimi i programit – MBN - BSc

Nr.		Vitet paraprake		Viti aktual
		2022/23	2023/24	2025/26
1	Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht	**4.00**	**3.80**	**4.54**
2	Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	**4.00**	**3.98**	**4.67**
3	Syllabusët e lëndëve ofrohen me kohë studentëve	**4.10**	**3.92**	**4.68**
4	Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	**3.90**	**3.89**	**3.74**
5	Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	**3.85**	**3.80**	**4.46**
6	Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	**4.00**	**4.03**	**4.70**
7	Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësim-nxënies	**3.90**	**3.81**	**4.55**
8	Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë	**3.95**	**3.75**	**4.43**
9	Sistemi i Menaxhimit elektorinik - SMIS është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	**3.90**	**4.02**	**4.28**
10	Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë	**3.85**	**3.81**	**4.72**
11	Ekziston një lidhje e mirë e mësimit teorik dhe atij praktik	**3.80**	**3.70**	**4.49**
12	Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore	**3.85**	**3.94**	**4.98**
13	Orari i mësimit shpallet me kohë	**3.95**	**3.82**	**4.85**
14	Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit	**3.95**	**3.83**	**4.88**
15	Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	**3.85**	**3.81**	**4.60**
16	Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	**3.85**	**3.80**	**4.51**
17	Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)	**3.75**	**3.80**	**4.72**
18	Puna praktike jashtë institucionit orgaznizohet mirë nga universiteti	**3.75**	**3.65**	**4.62**
19	Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	**3.75**	**3.75**	**4.76**
20	Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	**4.00**	**3.90**	**4.68**
21	Këtë program të studimit do t’ia sugjeroja edhe të tjerëve	**3.85**	**3.90**	**4.75**
	Mesatarja e përgjithshme:	**4.00**	**3.88**	**4.61**

Nga analiza e të dhënave vijmë në përfundimin se vlerësimi përfundimtar në nivel të programit është 4.61 - që është një vlerësim shume i mire, menaxhmenti i fakultetit dhe stafi i angazhuar në mësim pranë Fakultetit duhet te angazhohen për vijueshmëri me synim përmirësimin e vlerësimit në periudhën e ardhshme vlerësuese. Duke u bazuar në rezultatet e përpunuara nga të dhënat e mbledhura në sistem për vlerësimin e programit – rrjedh se duhet synuar përmirësim të vazhdueshëm në komponentët qe kërkojnë një angazhim ma të madhë – që është: orari i konsultimeve me studentë – i cili është i vlerësuar me notën nënë 4, komponentët tjera janë te vlerësuara me notë mbi 4 dhe të njëjtat duhet të monitorohen për vijueshmëri - për te gjitha komponentët duhet angazhim i menaxhmentit, i komitetit të programit dhe organizim i stafit ne funksion të ngritjes së cilësisë dhe të rezultateve.

4. Raporti i vlerësimit të Infrastrukturës/shërbimeve

Vlerësimi i infrastrukturës/shërbimeve të Fakulteti i Menaxhmentit - programi Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia (MBN) 2025/26 është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 19 komponentë, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate e vlerësimit për infrastrukture/shërbime të paraqitura në Tabelën nr.4, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesioni janë vlerësuar pozitivisht nga studentët (me nota solide), nota është 3.24 që është një vlerësim i mirë – i cili kërkon angazhim të theksuar për tu përmirësuar në vitin pasues.

Tabela nr.4 - Vlerësimi i infrastrukturës/shërbimeve

Nr.		Viti aktual
		2025/2026
1	Menaxhmenti është i hapur për vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e studentëve.	**3.48**
2	Drejtori (udhëheqësi) i programit është në kontakt të vazhdueshëm me studentë.	**3.65**
3	Zyra për marrëdhënie me jashtë ofron informacione të bollshme për studentë.	**3.35**
4	Shërbimet e administratës së universitetit janë të kënaqshme.	**3.29**
5	Sallat e mësimit dhe laboratorët ofrojnë kushte të nevojshme për mësim cilësor.	**3.08**
6	Mirëmbajtja e hapësirave universitare (niveli i pastërtisë) është në nivelin e duhur.	**3.31**
7	Sallat e kompjuterëve janë në dispozicion të studentëve.	**2.71**

8	Universiteti ka bibliotekën me literaturë profesionale të mjaftueshme	**3.09**
9	Biblioteka universitare është e pajisur me libra dhe literaturë elektronike bashkëkohore.	**2.36**
10	Universiteti posedon salla të veçanta të leximit për studentë.	**3.32**
11	Shërbimet për studentët me aftësi të kufizuara në Universitet janë në shkallë të duhur.	**3.02**
12	Studentët kanë qasje në shtypjen dhe fotokopjimin e materialeve për lexim.	**2.95**
13	Tabelat e shpalljeve për studentë përmbajnë informacione të bollshme dhe të vazhdueshme.	**3.43**
14	Web-faqja e universitetit ka informata të mjaftueshme për student	**3.45**
15	Komunikimi përmes mediave socialë është rëndësishëm për informim	**3.51**
16	Zyra për zhvillim të karrierës ofron këshillime të dobishme për studentë.	**3.53**
17	Personeli i njësisë si Teknologjisë Informative ofron shërbime të nevojshme.	**3.54**
18	Parlamenti i studentëve angazhohet për interesat e të gjithë studentëve në universitet.	**3.53**
19	Universiteti ofron qasje në internet për studentë në të gjitha pjesët e objektit	**3.33**
	Mesatarja e përgjithshme:	**3.24**

Duke u bazuar në të dhënat e përpunuara dhe të prezantuara në tabelën nr.4 (vlerësimi i infrastrukturës/shërbimeve), vijmë në përfundimin se komponentët e vlerësuara kanë marrë notë mesatare mbi 3 – që konsiderohet një vlerësim i mire, mirëpo ky vlerësim duhet të jetë një indikator se menaxhmenti i Fakultetit, stafi dhe komiteti i programit duhet të bëjnë përpjekje serioze për ta përmirësuar gjendjen dhe në vitin pasues vlerësimi për infrastrukture dhe shërbime të jetë më i mirë, janë disa komponentë që janë vlerësuar me notë nënë 3 dhe që kërkojnë vëmendje më të madhe psh komponentët – “Sallat e kompjuterëve në dispozicion të studentëve”, “Studentët kanë qasje në shtypjen dhe fotokopjimin e materialeve për lexim”, “Biblioteka universitare është e pajisur me libra dhe literaturë elektronike bashkëkohore”, “Shërbimet për studentët me aftësi të kufizuara në Universitet janë në shkallë të duhur” si dhe “Shërbimet e administratës së universitetit janë të kënaqshme” – të gjitha komponentët (me theks te veçante ato të vlerësuara më pakë) duhet të analizohen detalisht dhe të identifikohen hapat për ta përmirësuar gjendjen, të gjitha komponentët duhet të trajtohen me seriozitet nga menaxhmenti i Fakultetit dhe të njëjtat duhet të përmirësohen në mënyrë që të njëjtat të vlerësohen më mirë në periudhën pasuese vlerësuese.